

VENDIM
Nr.497, datë 8.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.524, DATË 30.7.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MASËN DHE MËNYRËN E KOMPENSIMIT TË QIRASË SË
BANESËS DHE TË USHQIMIT TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.524, datë 30.7.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura (oficer, nënoficer, ushtar profesionist), që për shkak të detyrës, emërohet ose transferohet larg vendbanimit dhe nuk është trajtuar me banesë ose me kredi nga Ministria e Mbrojtjes, dhe kur ai ose ndonjë pjesëtar i familjes nuk ka banesë në pronësi në vendin e punës, përfiton kompensim për qira banese deri në tre vjet.

Masa e kompensimit të qirasë së banesës të jetë:

-70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit garsionerë, kur është beqar ose i martuar dhe pa fëmijë;

-70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit 1+1, kur është i martuar dhe ka një fëmijë;

- 80 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit 2+1, kur është i martuar dhe ka më shumë se një fëmijë.

Çmimi mesatar i qirasë së banesës përcaktohet, çdo vit, nga Ministria e Financave dhe Ministria e Mbrojtjes.”.

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Ushtaraku aktiv (oficer, nënoficer, ushtar profesionist), që përfiton kompensim për qira banese, duhet të paraqesë pranë strukturës ushtarake përkatëse këto dokumente:

a) Kërkesën për kompensimin e qirasë së banesës;

b) Certifikatën personale;

c) Certifikatën familjare;

ç) Kontratën e qirasë së banesës, të noterizuar;

d) Vërtetimin përkatës, se nuk është trajtuar me banesë apo me kredi nga Ministria e Mbrojtjes;

dh) Vërtetimin përkatës se ai/ajo ose pjesëtarët e familjes, nuk kanë banesë në pronësi.

Këto dokumente rifreksohen çdo vit”.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha